



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

PLANI VJETOR I AUDITIMIT 2024/2025

(për sezonin auditues - 2024/2025)



Prishtinë, tetor 2024

TABELA E PËRMBAJTJES

1.VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT	3
2.HYRJE.....	5
3.AUDITIMET - LLOJET DHE PROCESI I AUDITIMEVE	6
4.OBJEKTIVAT E PLANIT VJETOR TË AUDITIMIT	11
5.BUXHETI DHE BURIMET NJERËZORE	21
6.ZBATIMI I PLANIT VJETOR	22
Shtojca 1. Plani operativ-subjektet dhe temat	23

1. VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT



VIZIONI

Institucion Suprem i Auditimit i besueshëm dhe model që i shton vlerë përdorimit të fondeve publike.



MISIONI

Nëpërmjet auditimeve cilësore ofrojmë siguri në shfrytëzimin e pasurive dhe parasë publike, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve për qytetarë dhe rritjen e llogaridhënies publike.



VLERAT E ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)

Pavarësia

Pavarësia nënkupton që i gjithë procesi i auditimit t'i nënshtrohet vetëm kërkesave të standardeve profesionale dhe të jetë jashtë ndikimit të palëve të treta. Pavarësia është elementi kryesor për të siguruar besimin e publikut dhe të Kuvendit të Kosovës, duke u ofruar atyre informacione të besueshme dhe të paanshme.

Profesionalizmi

ZKA udhëhiqet në veprimtarinë e saj audituese nga standardet profesionale të ONISA/INTOSAI dhe nga praktikat më të mira të vendeve.

Integriteti

ZKA angazhohet për mishërimin e vlerave më të mira etike, profesionale dhe morale. Veprimtaria e auditimit kryhet në mënyrë të ndershme dhe jashtë çdo konflikti të interesit.

Transparenca

ZKA është organizatë e hapur dhe do t'i bëj publike të gjitha aktivitetet e saj të rëndësishme. Po ashtu do t'i ofroj publikut të gjerë informacionin e përfituar nga auditimi, në përputhje me rregullat ligjore dhe standardet profesionale. ZKA angazhohet që të promovoj transparencën edhe në subjektet e audituara, si një element i qeverisjes së mirë.

Fryma ekipore

Në ZKA procesi i auditimit kryhet në mënyrë profesionale dhe bashkëpunuese në mes kolegëve në ekip dhe në nivele të ndryshme organizative, kështu promovojmë frymën ekipore si vlerë e shtuar për ZKA-në.

2. HYRJE

Zyra Kombëtare e Auditimit ("ZKA") si Institucion Suprem i Auditimit ("ISA") kryen auditimin e jashtëm të sektorit publik në Republikën e Kosovës. Mandati dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm janë përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës ("Ligjin e ZKA-së").

ZKA, auditon Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të të gjitha organizatave buxhetore për të vlerësuar nëse ato ofrojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë dhe nëse paraja publike është shpenzuar për qëllimet për të cilat është miratuar. ZKA kryen auditime të pajtueshmërisë për të ofruar përdoruesve të synuar informacione për atë nëse organizatat buxhetore të audituara i përmbahen ligjeve, akteve legislative, politikave, udhëzuesve, vendimeve, kodeve të vendosura, standardeve dhe kushteve të dakorduara të kontratave dhe memorandumeve të mirëkuptimit. Përveç kësaj kryen edhe auditime të performancës me synim të përmirësimit të shërbimeve për qytetarët dhe vlerës për para.

Ligji Nr.05/L-055 për ZKA-në, respektivisht neni 20, përcakton që AP të hartoj Planin Vjetor të Auditimit (PVA), i cili përfshinë të gjitha aktivitetet audituese për sezonin auditues dhe dorëzohet tek Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP), për çdo vit deri më 31 tetor të vitit përkatës.

Në hartimin e këtij dokumenti është vepruar në përputhje me Ligjin e ZKA-së në përmbushjen e obligimeve kushtetuese e ligjore për auditime të rregullsisë¹.

Përzgjedhja e temave për auditime të performancës është bazuar në vlerësimin e ndikimit në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve, përmirësimin e qeverisjes dhe mundësinë që të shtoj vlerë në menaxhimin e financave publike. Si proces i rregullt në konsultime me shoqërinë civile dhe OJQ është vlerësuar niveli i rrezikut (qasjen e bazuar në rrezik). Mbi këtë bazë janë përfshirë edhe auditimet e ndërmarrjeve publike.

Plani vjetor i auditimit përmban informatat relevante në lidhje me auditimet e përzgjedhura nga Auditorja e Përgjithshme për sezonin auditues, përfshirë: projektet, aktivitetet, afatet, burimet e nevojshme, buxhetin, rezultatet dhe rreziqet që mundet të ballafaqohet ZKA.

Auditimet do të realizohen në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ("SNISA"), dhe Korniza e Deklarimeve Profesionale (IFPP). Po ashtu procesin e auditimit e bazojmë në parimet universale të ISA-ve dhe të Zyrës Kombëtare të Auditimit siç janë: pavarësia, profesionalizmi, integriteti, transparenca dhe fryma ekipore. Të gjitha raportet e ZKA-së janë të qasshme për palët e interesuara dhe publikohen në faqen zyrtare të internetit të ZKA-së.

¹ Megjithëse në ligjin për ZKA përdoret termi auditim i rregullsisë, sipas SNISA-ve të përditësuara nuk përdoret me tutje ky term. Ky lloj i auditimit tashmë emërtohet me termin Auditimi Financiar dhe i Pajtueshmërisë, pasi që standardet SNISA-t i trajtojnë ndaras auditimet financiare nga ato të pajtueshmërisë.

3. AUDITIMET - LLOJET DHE PROCESI I AUDITIMEVE

Auditimi financiar dhe i pajtueshmërisë ka për qëllim rritjen e nivelit të besueshmërisë së përdoruesve të synuar të Pasqyrave Financiare dhe përdorimi i fondeve publike në pajtueshmëri me autoritetet. Sipas Standardave Ndërkombëtare të Insitucioneve Supreme të Auditimit, Deklaratës Profesioanale të INTOSAI-it standardi 100, njihen tre lloje të auditimeve të sektorit publik: auditime financiare, auditime të pajtueshmërisë dhe auditime të performancës.

Sipas Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe ZKA-në, është përcaktuar auditim i detyrueshëm i rregullsisë, me qëllim të përmbushjes së kësaj kërkesë ky auditim nënkupton auditim financiar i kombinuar me auditimin e pajtueshmërisë.

3.1. Llojet e auditimeve

Në përputhje me mandatin dhe fushëveprimin e ZKA-së, gjatë sezonit 2024/25 do të kryhen këto lloje të auditimeve:



Auditimi Financiar dhe i Pajtueshmërisë: përfshinë auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të institucionit me qëllim të vlerësimit nëse raportet financiare janë të besueshme dhe pasqyrojnë rezultatet e realizimit të buxhetit në mënyrë të drejtë; vlerësimin nëse menaxhmenti u është përmbajtur ligjeve dhe akteve nënligjore të zbatueshme dhe nëse fondet janë përdorur për qëllimet e synuara; vlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar, funksionet e auditimit të brendshëm dhe sistemet e kontrollit të brendshëm.

Objektivat e auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë përkufizohen si siguri e arsyeshme, e cila i ofrohet shfrytëzuesve të Pasqyrave Financiare, nëse Pasqyrat Financiare të audituara janë në tërë kuptimin

material të vërteta dhe të drejta (apo të paraqitura drejtë) dhe nëse transaksionet e raportuara në ato pasqyra janë kryer në pajtueshmëri me autoritetet².

Auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë kryhen për çdo vit. Procesi i auditimit fillon në shtator, ndërsa raportet e auditimit për OB-të individuale dhe ndërmarrjet publike, publikohen deri në fund të muajit qershor. Cikli i auditimeve përmbyllet në fund të muajit gusht kur Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës. Pavarësisht nga burimi i kriterëve, auditori kryen auditimin dhe formon një përfundim me nivelin e zgjedhur të sigurisë, në përputhje me kërkesat në ISSAI 2000³.

Auditimet e pajtueshmërisë: Objektivi i auditimit të pavarur të pajtueshmërisë është t'u ofrojë përdoruesve të synuar informacione për atë nëse entitetet publike të audituara i përmbahen ligjeve, akteve legjislative, politikave, udhëzuesve, vendimeve, kodeve të vendosura, standardeve dhe kushteve të dakorduara të kontratave dhe memorandumeve të mirëkuptimit.

Auditimi i pajtueshmërisë përfshinë si aspektet e rregullsisë (respektimi/bindja me kriteret formale siç janë ligjet, rregulloret dhe marrëveshjet përkatëse) dhe/ose konformitetit (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publikë). Pavarësisht nga burimi i kriterëve, auditori kryen auditimin dhe formon një përfundim me nivelin e zgjedhur të sigurisë, në përputhje me kërkesat në ISSAI 4000⁴.

Auditimet e performancës: paraqesin një shqyrtim të pavarur, objektiv dhe të besueshëm nëse angazhimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat janë duke vepruar në përputhje me parimet e:

- **ekonomicitetit** (minimizimi i kostove të burimeve);
- **efikasitetit** (përfitimi sa më shumë nga burimet në dispozicion) dhe
- **efektivitetit** (përmbyllja e objektivave të përcaktuara dhe rezultateve të synuara).

Fushat, objektivat dhe koha e auditimit dhe e raportimit përcaktohen prej rastit në rast, duke u bazuar në rëndësinë, rrezikun, fushëveprimin e auditimit, kapacitetet ekzistuese si dhe kriteret tjera përkatëse.

Auditimi i performancës fokusohet në atë se si organizatat e sektorit publik i kanë përdorur burimet në dispozicion për t'i arritur objektivat e tyre. Për ekzaminimin e performancës së entitetit të audituar, ZKA-ja ndjek një rën nga tri qasjet:

- qasjen e orientuar në **rezultate**, e cila vlerëson nëse janë arritur objektivat e paracaktuara;
- qasjen e orientuar në **problem**, e cila verifikon dhe analizon shkaqet e problemit/eve ose
- qasjen e orientuar në **sistem**, e cila ekzaminon funksionimin e sistemeve menaxhuese, ose një kombinim të tri qasjeve.

² "Pajtueshmëri me autoritetet" do të thotë pajtueshmëri me aktet apo rezolutat e legjislaturës apo instrumente tjera statutores, direktiva dhe udhëzues të nxjerra nga organet e sektorit publik me kompetenca të përcaktuara me statut, të cilave pritet t'i përmbahet entiteti i audituara. Thënë ndryshe, është pajtueshmëri me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira.

³ Auditimi Financiar (Parimet e AF-së SNISA 200-299, Standardet e AF SNISA 2000-2899, Udhëzimi Plotësues i AF GUID 2900-2999)

⁴ Auditimi i pajtueshmërisë (Parimet e AP-së SNISA 400-499, Standardet e AP SNISA 4000-4899, Udhëzimi plotësues i AP 4900-4999).

Në kuadër të auditimeve të performancës përfshihen edhe Auditime të teknologjisë së informacionit (TI-së), që definohet si ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të TI-së dhe kontrollet e ndërlidhura me to, për të përfituar siguri ose për të identifikuar rreziqet lidhur me parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, ekonomicitetit dhe efektivitetit të sistemeve të TI-së dhe kontrolleve lidhur me këto sisteme. Pavarësisht nga burimi i kriterëve, auditori kryen auditimin dhe formon një përfundim me nivelin e zgjedhur të sigurisë, në përputhje me kërkesat në ISSAI 3000⁵

3.2. Procesi i auditimeve

A. Procesi i auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë - bazohet në metodologjinë e auditimit të përshkruar në Doracakun e Auditimit Financiar dhe të Pajtueshmërisë (Metodologjia e qasjes së kombinuar) dhe SNISA-t. Auditimi i rregullsisë kryhet nëpër disa hapa duke filluar nga njohja e entitetit dhe analiza e rreziqeve:

- planifikimi i auditimit;
- ekzekutimi i auditimit;
- dhënia e konkluzioneve dhe opinionit të auditimit;
- raportimi në Kuvend dhe informimi i opinionit publik (publikimi i raporteve) dhe
- përcjellja e adresimit të rekomandimeve të auditimit (plani i veprimit).

Grafiku 1: Fazat e procesit të auditimit financiar dhe pajtueshmërisë.



Faza 1. Planifikimi përfshin dy periudha:

⁵ Auditimi i Performancës (Parimet e AP SNISA 300-399, Standardet e AP SNISA 3000-3899, Udhëzuesi plotësues i AP GUID 3900-3999).

- Planifikimi i përgjithshëm i auditimit, për mbledhjen e sa më shumë informacioneve lidhur me entitetin, i cili po auditohet gjë e cila bëhet në mënyrë më efektive përmes punës përgatitore në zyrën e ZKA-së, një vizite njëditore në terren për ta takuar menaxhmentin e lartë të entitetit dhe
- Planifikimi i detajuar i auditimit, një planifikim i auditimit në hollësi, që bazohet në analizën tonë fillestare, vlerësimin e hollësishëm të rrezikut, dhe vlerësimin e kontrollit të brendshëm. Për t'i plotësuar objektivat tona të auditimit, dizajnohen procedurat e mëtutjeshme thelbësore të auditimit. Kjo duhet të përmbledhet në një Memorandum të Planifikimit të Auditimit.

Faza 2. Ekzekutimi, përfshin mbledhjen, testimin dhe analizimin e dëshmive të auditimit me rezultate të paraqitura, si dhe hartimin e draft raportit të auditimit ku vlerësohen rezultatet e arritura.

Faza 3. Raportimi, përfshin përmbledhjen e konkluzioneve dhe opinionin e auditimit me një raport mbi rezultatet për auditimin e Pasqyrave Financiare në pajtueshmërisë me autoritetet. Kjo do të rezultojë me opinione /konkluzione zyrtare të auditimit.

Faza 4. Zbatimi i rekomandimeve duhet të përcjellët përmes auditimeve pasuese me cilëndo nga procedurat relevante të auditimit, për t'u siguruar që deklaratimet e menaxhmentit lidhur me zbatimin e tyre janë të sakta dhe të drejta.

B. Procesi i auditimeve të performancës dhe të pajtueshmërisë - bazohet në metodologjinë e auditimit të përshkruar në Doracakun e Auditimeve të Performancës dhe SNISA-t. Auditimi i performancës dhe ai i pajtueshmërisë kanë qasje të njëjtë dhe kryhet nëpër fazat në vijim:

Grafiku 2: Fazat e procesit të auditimit të performancës



Faza 1. Planifikimi. Përfshinë propozimin e temave për auditim dhe përgatitjen e memove parastudimore. Propozimet shqyrtohen përmes një procesi vlerësues lidhur me përshtatshmërinë dhe rëndësinë e temës për t'u audituar. Në këtë fazë po ashtu, ekipet e auditimit bëjnë një hulumtim më të thellë rreth temës

përkatëse, ku përcaktohen: problemi i auditimit, objektivat e auditimit, motivi i auditimit, fushëveprimi i auditimit, etj.

Faza 2. Ekzekutimi i punës në terren. Ekipet e auditimit pasi që të kenë përgatitur planin detaj të punës fillojnë me kryerjen e punëve audituese në terren dhe të hartojnë draft raportin e auditimit.

Faza 3. Raportimi. Ekipi auditues përfundon hartimin e raportit të auditimit, i cili duhet të jetë objektiv, gjithëpërfshirës, i qartë për lexuesin, etj. Pasi që raporti ka kaluar nëpër kontrollin e cilësisë dhe janë dhënë aprovimet e duhura, bën publikimin e tij.

Faza 4. Përcjellja e auditimit. Pasi të ketë kaluar një periudhë e përshtatshme kohe, ZKA-ja mund të kryejë një vlerësim të progresit të entitetit të audituar në përgjigjet ndaj gjetjeve të auditimit dhe zbatimit të rekomandimeve dhe të raportojë për to përmes një auditimi përcjellës. Bazuar në standardet e auditimit si dhe në Doracakun për auditime të performancës, auditimet përcjellëse jo domosdoshmërisht kryhen për secilin auditim të kryer paraprakisht. Lidhur me auditimet përcjellëse vendoset në bazë të rëndësisë së temës.

Procesi i auditimit financiar dhe i pajtueshmërisë në ZKA monitorohet dhe rishikohet nga Departamenti për Metodologji dhe Departamenti për Sigurimin e Cilësisë, të cilat kanë përgjegjësi për të siguruar menaxhmentin që auditimet janë kryer duke u bazuar në metodologjinë e aprovuar nga Auditori i Përgjithshëm dhe SNISA-t.

4. OBJEKTIVAT E PLANIT VJETOR TË AUDITIMIT

Zyra Kombëtare e Auditimit planifikon punën e audituese në baza vjetore, i cili bazohet në objektivat e Planit Strategjik. Objektivat e ZKA-së për sezonin auditues 2024/25 janë përputhje me kërkesat ligjore që synohet në rritjen e ndikimit në përmirësimin e qeverisjes dhe mundësinë që të shtoj vlerë në menaxhimin e financave publike.

Në sezonin auditues 2024/2025 janë planifikuar 139 auditime. Plani auditues përfshin:




Tabela 1: Numri dhe lloji i auditimeve të planifikuara për sezonin e auditimit 2024/2025

Llojet e auditimit					
Auditime të rregullsisë (financiare dhe pajtueshmërisë)	Numri	Auditime të pajtueshmërisë/klasifikuara	Numri	Auditime të performancës	Numri
Buxheti i Kosovës-RVA	1	Auditime të pajtueshmërisë	11	Auditime të performancës	5
Institucione të nivelit qendror	49	Auditime të klasifikuara	3	Auditime të prokurimit	5
Komuna	38			Auditime të TI-së	3
Ndërmarrje publike	12			Auditime të performancës vazhdim nga viti paraprak	4
Projekte të financuara nga fondet e jashtme	8				
Gjithsej	108	Gjithsej	14	Gjithsej	17
Gjithsej numri i auditimeve për sezonin 2024/2025					139

Të gjitha auditimet (me përshkrim) janë paraqitur në **Shtojcën 1** të këtij dokumenti.

Raportet individuale për auditimet e rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë) do të finalizohen deri më 30 Qershor 2025, si dhe në përputhje me afatin ligjor, Raporti Vjetor i Auditimit për Buxhetin e Kosovës pritet t'i dorëzohet Kuvendit të Kosovës jo më vonë se 31 gusht të vitit 2025.

Auditimet e performancës, pajtueshmërisë dhe të projekteve do të publikohen sipas kalendarit kohor të përcaktuar dhe aprovuar nga Auditori i Përgjithshëm.

Angazhimi i burimeve njerëzore në procese audituese është bërë duke marrë parasysh: disponueshmërinë me burime njerëzore, kualifikimin dhe përvojën e stafit, madhësinë e buxhetit që auditohet, rrezikshmërinë, si dhe kompleksitetin e temës audituese.

4.1. Objektivi i auditimeve të rregullsisë

Përveç auditimeve të rregullta vjetore, menaxhmenti i ZKA-së ka vendosur që në planin vjetor të auditimit të përfshijë 11 auditime të pajtueshmërisë, si dhe auditimin e pasqyrave të veçanta për nevojat e ZRRE-së dhe KPMM-së për dy ndërmarrjet publike (Trepça Sh.A, KEK dhe KOSTT-ti).

Për dallim nga viti i kaluar kemi zvogëluar kontraktimin e auditimit me kontraktim të Institucioneve të Pavarura prej 12 sa ishin, tani janë 10 të kontraktuara, ndërsa tek komunat është numri i njëjtë

me vitin paraprak (10 të kontraktuara). Auditimi i 10 institucioneve të pavarura dhe 10 komunave do të përkrahjet nga një kompani private e auditimit, përderisa monitorimi i tyre dhe opinioni i auditimit përcaktohet nga Auditori i Përgjithshëm bazuar në metodologjinë e ZKA-së dhe SNISA-ve.

ZKA ka mekanizma të brendshëm në funksion të trajtimit të kërkesave të ndryshme që vijnë nga palët e jashtme për auditime me kërkesë, dhe si të tilla trajtohen në mënyrën efektive.

Mënyra e përzgjedhjes së auditimeve të rregullsisë. Përveç auditimeve të detyrueshme të rregullsisë të përcaktuar me ligj, fokus i veçantë i është dhënë auditimeve të pajtueshmërisë, ndërmarrjeve publike dhe projekteve të Bankës Botërore.

Fushëveprimi i auditimit apo qasja e auditimit nuk do të ndryshojë nga vitet paraprake, por do të ketë fokus më të madh në fushat që mund të pritjet apo vlerësohet që mund të jenë më me rrezik dhe të kenë ndonjë shmangie nga rregullativa ligjore.

Planifikimi i auditimit është pjesë shumë e rëndësishme e procesit të auditimit për arsye se i jep drejtim auditimit, duke u bazuar në një vlerësim të rreziqeve që kanë të bëjnë me entitetin, prandaj një auditim efektiv dhe efikas mbështetet mbi planifikimin në mënyrën e duhur të proceseve dhe procedurave.

Ne kemi zhvilluar një strategji dhe qasje të detajuar për punën specifike në mënyrë që auditimi të kryhet në mënyrë efektive dhe në kohën e duhur. Qëllimi ynë është që të bëhet i sigurt fakti se çështjeve të auditimit iu kushtohet rëndësia e duhur dhe çështjet problematike identifikohen dhe trajtohen siç duhet brenda mandatit kushtetues dhe ligjor. Do të kemi parasysh dhe do të bëjmë një përkrahje të natyrës, kohëzgjatjes dhe shtrirjes së procedurave të nevojshme të auditimit. Të njihet entiteti dhe mjedisi ku vepron, përfshirë këtu kontrollet e brendshme, aq mjaftueshëm sa të jetë në gjendje të identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qofshin ato si rrjedhojë e mashtrimeve ose gabimeve, dhe aq mjaftueshëm sa të jemi të aftë të krijojmë dhe kryejmë procedurat e mëtejshme të auditimit.

4.1.1. Rreziqet e auditimit

Për auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë, para përgatitjes së planit auditues vlerësohen rreziqet për të gjitha institucionet. Si pjesë e punës për zhvillimin e planit vjetor të auditimit, ne shqyrtojmë edhe rreziqet potenciale sinjifikante. Rreziqet sinjifikante janë rreziqe të vlerësuara të anomalive materiale sipas gjykimit të auditorëve, kërkojnë vëmendje të veçantë të auditimit që kanë rezultuar gjatë proceseve individuale të auditimit në OB dhe janë evidentuar në RVA. Ne këtë sezonë audituese përveç çështjeve tjera, vëmendje do i kushtohet:

- Keq klasifikimit të shpenzimeve në OB;
- Menaxhimit të pasurive financiare;
- Llogarive të arkëtueshme dhe
- Detyrimeve të papaguara dhe kontigjente.

- Sipas Rregullës financiare nr. 01/2013 - **Shpenzimi i Parave Publike**, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.
- Rregullorja MF nr. 02/2013 mbi **Menaxhimin e Pasurive** në Organizata Buxhetore i obligon të gjitha organizatat të mbajnë regjistrat e pasurisë jo financiare që ka në menaxhimin e saj. Vazhdimisht të bëjnë azhurnimin e tyre, varësisht nga blerjet/përvetësimet e reja apo shqyrtimit sistematik të gjendjes së tyre të përdorimit.
- Rregullorja MF nr.01/2017 për **Raportim Vjetor Financiar** i obligon OB të mbajnë regjistrat e Llogarive të Arkëtueshme. Të arkëtueshmet paraqesin një zë të rëndësishëm për qëllime të menaxhimit financiar. OB-të që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistrat të shumave të faturuara e të pa arkëtuara të cilët shërbejnë si bazë për raportimin financiar. OB-të janë të detyruara të bëjnë inkasimin e LLA në kohë reale, për faktin se vjetërsia e këtyre llogarive vështirëson inkasimin dhe rrezikon me humbje financiare për OB-të.
- Ligji i buxhetit dhe rregullativa sekondare për **Shpenzimin e Parasë Publike**, kufizon hyrjen e OB-ve në detyrime, meqë obligohen që porosinë e mallit/punëve (urdhër blerjen) ta bëjnë vetëm kur ka mjete në dispozicion. Detyrimet e papaguara/kontigjente paraqesin faturat e pranuar për punët/shërbimet e përfunduara nga operatorët ekonomik, por të cilat nuk janë paguar. Për shkak të përdorimit të kontabilitetit në para të gatshme, gjendja e detyrimeve të papaguara vetëm mund të shpaloset në pasqyrat financiare, aq më tepër kur një qasje e tillë e mbledhjes së informatave jashtë SIMFK-së, lë hapësirë për gabime të mundshme në raportimin apo shpalosjen e tyre.

4.1.2. Përgjigja e Auditimit

Në planifikimin e auditimit do të kemi fokus të veçantë ndaj këtyre rreziqeve. Si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve do të bëjmë punë shtesë duke dizajnuar një program të veçantë të auditimit për klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e pasurive, Llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet e papaguara/kontigjente.

Ne do të shqyrtojmë sistemet tjera të kontabilitetit dhe kontrollet e menaxhmentit vetëm aq sa ne e konsiderojmë të nevojshme për të kryer një auditim efektiv. Si rezultat, shqyrtimi ynë mund të mos zbulojë të gjitha mangësitë apo të gjitha përmirësimet që mund të bëhen. Aty ku ne zbulojmë çfarëdo mangësie apo dobësie të rëndësishme, ne do të raportojmë me rekomandime për përmirësim.

Në planin vjetor të auditimit, për institucionet e mëdha dhe komplekse, fokusi bëhet tek shpërndarja e stafit sipas kualifikimeve, përvojës dhe kompetencës profesionale.

Me qëllim të mbulimit të auditimeve mandatore krahas burimeve njerëzore, të cilat nuk mund të mbulojnë me stafin e rregullt, ZKA bën vlerësimin e rreziqeve për auditimet, ashtu që auditimet me më pak rreziqe kontraktohen nga kompani private të licencuara të auditimit.

4.2. Objektivi i auditimeve të pajtueshmërisë

Objektivi i auditimit të pajtueshmërisë është t'u ofrojë përdoruesve të synuar informacione për atë nëse entitetet publike të audituara i përmbahen ligjeve, akteve legjislative, politikave, udhëzuesve, vendimeve, kodeve të vendosura, standardeve dhe kushteve të dakorduara të kontratave dhe memorandumeve të mirëkuptimit. Këto auditime kryhen në përputhje me kërkesat në ISSAI 400 dhe 4000.

Për vitin 2023, me mbështetje të USAID projektit Integriteti i Komunave të Kosovës kemi publikuar dy auditime të veçanta të pajtueshmërisë. Duke marrë parasysh rëndësinë që aktivitetet si në nivel qendror ashtu edhe atë lokal të kryhen në pajtueshmëri me autoritetet, për sezonin auditues 2024/2025 kemi planifikuar 11 auditime të veçanta të pajtueshmërisë.

Objektiva dhe fushëveprimi i këtyre auditimeve do të përcaktohen pas analizimit dhe identifikimit të rreziqeve në fusha specifike.

4.3. Objektivi i auditimeve të performancës, prokurim, IT

Zyra Kombëtare e Auditimit vazhdon t'i japë rëndësi të veçantë auditimeve të performancës dhe teknologjisë së informacionit. Për sezonin auditues 2024/2025 do të mbulohen fusha me rëndësi:

- shëndetësi dhe mirëqenie;
- industri inovacion dhe infrastrukturë;
- konsum dhe prodhim i përgjegjshëm/prokurim publik i qëndrueshëm;
- qytete dhe komunitete të qëndrueshme;
- sigurimi i arsimit cilësor/barazia gjinore;
- sigurimi i qasjes në energji të përbalueshme;
- mbrojtja dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore;
- të zhvillohen institucione efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet
- inovacioni, infrastruktura dhe industrializimi.

Me qëllim të prioritizimit të fushave me interes dhe njëkohësisht maksimizimit të burimeve dhe rritjes së ndikimit përmes auditimeve të performancës në mirëqenien e qytetarëve, Zyra Kombëtare e Auditimit zhvillon një proces deri të përzgjedhja e fushave/temave të auditimit. Këtë vit Zyra Kombëtare e Auditimit ka filluar të bëjë planifikimin strategjik për identifikimin e fushave më me rrezik dhe prioritizimin e tyre në planin vjetor të auditimit, ku janë bërë hulumtime të fushave dhe probleme që i shoqërojnë ato fusha. Përveç këtij hulumtimi, janë analizuar raportet e auditimit të rregullsisë apo pajtueshmërisë për identifikimin e mangësive kyçe si dhe janë ftuar auditorët të propozojnë tema bazuar në njohuritë e tyre dhe problematikat e hasura gjatë auditimeve paraprake.

Përveç hulumtimeve dhe propozimeve nga auditorët e ZKA-së, është organizuar edhe tryezë për të diskutuar me palë të jashtme të interesit, pra me Shoqërinë Civile si OJQ, organizata profesionale,

komuniteti i donatoreve dhe ekspertë të fushave, për diskutimin e temave duke u dhënë mundësi pjesëmarrësve për ofrimin e propozimeve.

ZKA synon të promovojë efikasitetin, llogaridhënien, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike përmes këtyre auditimeve:



Qëllimi: Shëndeti dhe mirëqenia

Furnizimi me barna për shëndetësinë primare dhe sëmundjet e rralla. Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për sigurimin dhe furnizimin me barna për sektorin primar të shëndetësisë dhe të sëmundjeve të rralla, fokusi do të jetë ndarja e buxhetit për këto dy lloje të furnizimit, zhvillimi i procedurave të prokurimit si dhe shpërndarja e tyre në qendrat e mjekësisë familjare respektivisht tek pacientet me sëmundje të rralla.

Qëllimi i këtij auditimi është të vlerësoj nëse buxheti i ndarë për këto furnizime është shfrytëzuar në mënyrë të duhur dhe të analizohet nëse barnat janë prokuruar dhe shpërndarë në mënyrë efektive dhe përmbushin nevojat e pacientëve me sëmundje të rralla dhe të shëndetësisë primare.




Qëllimi: Industri, inovacion dhe infrastrukturë

Menaxhimi i lejeve të ndërtimit në Fushë Kosovë. Sektori i ndërtimit në Komunën e Fushë Kosovës që nga paslufta ka pas zhvillim të hovshëm dhe është përcjellë me mangësi. Kjo për arsye se është shtuar dukshëm numri i banorëve në këtë komunë, ku sipas regjistrimit të popullsisë është dyfishuar numri i banorëve në krahasim me regjistrimin paraprak. Procedurat për marrjen e lejeve të ndërtimit nga ana e qytetarëve dhe kompanive ndërtimore konsiderohet të jetë burokratike. Numri i madh i ndërtimeve paraqet sfidë për institucionet publike për të kontrolluar ndërtimet se a janë të pajisura me leje si dhe a po respektohen kushtet ndërtimore.

Qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi i procesit të dhënies dhe menaxhimit të lejeve ndërtimore në Komunën e Fushë Kosovës si dhe ndikimin e tyre në infrastrukturën publike duke përfshirë respektimin e kushteve ndërtimore të cilat rezultojnë me pranimin apo mospranimin teknik të objekteve.

Ndërtimi i sheshit së bashku me nënkalimet dhe parkingun nëntokësor në qytetin e Malishevës. Ky projekt u kontraktua në vitin 2023, me një vlerë prej 8,277,887 euro. Projekti është i njohur si më i madhi në historinë e Komunës, duke premtuar përmirësimin e infrastrukturës dhe cilësisë së jetesës për qytetarët e Malishevës.

Ky auditim është një hap i rëndësishëm për të vlerësuar nëse ky investim në infrastrukturë po realizohet në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme, për të mirën e qytetarëve. Ky auditim do të vlerësoj nëse menaxhimi i këtij projekti është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe janë arritur rezultatet e synuara.



Qëllimi: Konsum dhe prodhim i përgjegjshëm/prokurim publik i qëndrueshëm

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës është institucion shëndetësor që ka për detyrë që të ofrojë shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor duke synuar performancë, efikasitet dhe efektivitet sa më të lartë të shërbimeve shëndetësore.

Qendra Klinike Universitare e Kosovës dhe shtatë Spitalet Rajonale janë institucione shëndetësore publike në kuadër të ShSKUK-së e të gjitha së bashku janë nën ombrellën e Ministrisë së Shëndetësisë. Kjo e fundit harton politika në mënyrë që këto institucione të ofrojnë shërbime mjekësore për qytetarët e vendit, në mënyrë efektive dhe efikase. Për të arritur këtë objektivë, infrastruktura (ndërtimi i objekteve spitalore) luan rol të rëndësishëm në këtë proces.

Ndërtimi i Objektivit të Ortopedisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. ShSKUK ka lidhur dy kontrata për këtë projekt, ndërsa ky objekt është inauguruar në fillim të tetorit të vitit 2024.

Objektivë e këtij auditimi është të vlerësojmë nëse është bërë identifikimi dhe përcaktimi i duhur i nevojave, nëse është bërë hulumtim i duhur i tregut dhe nëse projekti është kryer në përputhje me kushtet kontraktuale dhe brenda afateve optimale kohore.



Qëllimi: Qytete dhe komunitete të qëndrueshme

Realizimi i projekteve të financuara nga DEMOS/Helvetas. Bashkëpunimi mes ZKA-së dhe DEMOS/Helvetas ka filluar në vitin 2019, kur është nënshkruar kontrata e parë lidhur me auditimin e shfrytëzimit të Grantit të Performancës Komunale dhe ka vazhduar tutje edhe viteve tjera. Kjo është hera e gjashtë që DEMOS/Helvetas kërkon nga ZKA që të auditoj zbatimin, realizimin dhe ndikimin

e projekteve të financuara nga Granti i Performancës dhe sa këto projekte ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve të komunave përfituese.

Qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi se si janë menaxhuar dhe realizuar nga komunat përfituese projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale.



Qëllimi: Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe i barabartë, barazia gjinore dhe zvogëlimi i pabarazive.

Licencimi i institucioneve parashkollore dhe mbikëqyrja e tyre. Edukimi në fëmijërinë e hershme, luan një rol jetik në zhvillimin e fëmijëve dhe siguron një

bazë të fortë për rritjen e mëvonshme të tyre në aspektin emocional, edukativ dhe social. Ekzistojnë disa indikacione që tregojnë për problematikat e këtij niveli të edukimit. Në radhë të parë, mungojnë institucionet për edukim parashkollorë dhe një numër i madh i fëmijëve detyrimisht regjistrohen në institucionet private.

Gjithashtu, ka të dhëna se procesi i licencimit ka ndikuar në paraqitjen e in-formalitetit në sektorin privat, për këtë arsye një numër i çerdheve funksionojnë pa licenca. Gjithashtu ka indikacione për nivelin e dobët të mbikëqyrjes dhe monitorimit, gjë që ka ndikuar në krijimin e ambienteve jo të përshtatshme për këtë grup moshë, dhe ngrit problemin e parregullsive në licencim.

Qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi i procesit të licencimit të çerdheve, si dhe akviteteteve të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse shtetërore gjatë kontrollimit dhe mbikëqyrjes së këtyre insitucioneve.



Qëllimi: Sigurimi i qasjes në energji të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë.

Efiçienca e Energjisë - BRE (Burimet e Ripërtrishme të Energjisë). Sfidat në sektorin e energjisë janë të shumta, duke filluar nga furnizimi i pamjaftueshëm dhe i paqëndrueshëm nga termocentralet e vjetra të bazuara në linjit, konsumin jo efiçient të energjisë si dhe zhvillimin e pamjaftueshëm të burimeve të ripërtërishme të energjisë (BRE). Burimet energjetike të ripërtërishme të identifikuara në Kosovë janë; energjia me erë, energjia solare dhe biomasa.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT ShA)- është ndërmarrje publike që merret me operimin, menaxhimin dhe zhvillimin e sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë. Prodhuesit e BRE-ve kanë të drejtë të shesin prodhimin e tyre të energjisë elektrike tek Operatori i Tregut në KOSTT, përmes Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë (MBE) të lidhur me KOSTT-in.

Aktualisht janë 30 marrëveshje të nënshkruar mes KOSTT dhe prodhuesit e BRE-ve.

Megjithatë në vitin 2023, KOSTT kishte më shumë kosto se sa të hyra nga energjia e ripërtërishme.

Qëllimi i këtij auditimi është që të vlerësojë problematikat dhe sfidat sa i përket BRE në Kosovë si dhe rolin që kanë rregullatorët përgjegjës (ZRre dhe Ministria e Ekonomisë) dhe KOSTT sa i përket objektivave të BRE në Kosovë.



Qëllimi: Mbrojtja dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër shkretëtirimit dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit.

Mbrojtja, Zhvillimi dhe Ripërtëritja e Hapësirave Pyjore. Pyjet luajnë një rol kyç në ruajtjen e mjedisit dhe stabilitetit klimatik, duke ofruar përfitime të mëdha ekologjike, ekonomike dhe sociale. Ato ndihmojnë në mbajtjen e biodiversitetit, ruajnë cilësinë e ujit dhe ajrit, parandalojnë erozionin e tokës dhe kontribuojnë në zbutjen e ndryshimeve klimatike. Në Kosovë, megjithatë, pyjet përballen me një sërë sfidash, duke përfshirë prerjet ilegale, degradimin për shkak të zjarreve, ndërtimet e pakontrolluara dhe shfrytëzimin e tepërt të resurseve pyjore.

Qëllimi i këtij auditimi është të vlerësojë efektivitetin e masave dhe politikave që ndjekin institucionet përgjegjëse për mbrojtjen, zhvillimin dhe ripërtëritjen e hapësirave pyjore në Kosovë.



Qëllimi: Të zhvillohen institucione efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet.

Siguria dhe të drejtat e konsumatorëve në Kosovë. Në Kosovë të drejtat e konsumatorëve bazohen në ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve. Në kuadër të këtij ligji janë të mbrojtura të drejtat: ekonomike, mbrojtja nga rreziku për jetën, shëndeti, prona, e drejta për shfrytëzimin e të mirave publike. Megjithatë, ky ligj nuk mbulon të gjitha fushat si mbrojtjen e shërbimeve nga distanca apo shërbimeve kontraktuale mes ofruesve të shërbimeve dhe konsumatorëve.

Konsumatori ka të drejtë ankese në rast të shkeljes së këtyre të drejtave, si dhe ka të drejtë dëmshpërblimi nëse rezulton se është dëmtuar.

Qëllimi i këtij auditimi është të vlerësohet efektiviteti i mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në Kosovë, duke u fokusuar veçanërisht në fushat që nuk mbulohen nga ligji ekzistues për mbrojtjen e konsumatorëve.



Qëllimi: Inovacioni, Infrastruktura dhe Industrializimi, duke përmirësuar transparencën, përgjegjshmërinë dhe efikasitetin e institucioneve publike përmes integritit të sistemeve dhe avancimit të infrastrukturës teknologjike në administratën financiare. Paqe, drejtësi dhe institucione të forta.

Platforma për ofrimin e shërbimeve online e-Kosova. Portali shtetëror e-Kosova është ueb aplikacion për ofrimin e shërbimeve për qytetarët e Republikës së Kosovës në formë elektronike. Kjo platformë ka për qëllim ofrimin e shërbimeve në formë digjitale. Duke qenë se kemi të bëjmë me të dhëna personale, atëherë rëndësia e kësaj platforme është e lartë, dhe privatësia e siguria e këtyre të dhënave janë shumë të rëndësishme.

Qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi i sigurisë dhe efikasitetit të Platformës eKosova për modulet që kanë të bëjnë me pagesat dhe të dhënat personale, siç janë modulet: Arsimi, Tatimet, Familja, Automjeti, Policia, Komunalitë, Fondi i Sigurisë, Grantet dhe Subvencionet, por pa u kufizuar.

Integrimin e Sistemeve, Krijimin e Deponisë së Shënimeve dhe Implementimin e Inteligjencës së Biznesit. Projekti për Integrimin e Sistemeve, Krijimin e Deponisë së Shënimeve dhe Implementimin e Inteligjencës së Biznesit në Kosovë ka për qëllim përmirësimin e menaxhimit të të dhënave financiare dhe të administratës publike, duke krijuar një platformë që integrohet me sisteme ekzistuese për të analizuar dhe raportuar të dhënat. Kjo do të kontribuojë në transparencën dhe efikasitetin e vendimmarrjes në institucione qeveritare.

Qëllimi i këtij auditimi është që të vlerësojë nëse ky sistem është zbatuar në përputhje me planin e projektit dhe apo arrihen qëllimet e integritit të sistemeve dhe a përmbushen standardet për përmirësimin e administrimit financiar dhe inteligjencës së biznesit në institucionet publike.

5. BUXHETI DHE BURIMET NJERËZORE

ZKA-ja është institucion i pavarur, i cili financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës i cili miratohet nga Kuvendi i Kosovës, sipas procedurës së përcaktuar me Ligjin 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Bazuar në Ligjin e Buxhetit për vitin 2024, mjetet e ndara për ZKA-në janë 3,345,654€. Krahasuar me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2023, buxheti shënon një rritje të lehtë rreth 2.36%. Buxheti është i ndarë në katër kategori ekonomike: Paga dhe mëditje, Mallra dhe shërbime, Shërbime komunale dhe Investime kapitale.

Me buxhetin vjetor ka të miratuar 180 vende pune, mirëpo aktualisht ka të punësuar 163 punonjës. Numri prej 134 punonjësve janë të angazhuar drejtpërdrejt në auditim, kurse pjesa tjetër në shërbimet tjera menaxheriale, administrative dhe mbështetëse.

Për të arritur qëllimet dhe objektivat strategjike, ZKA-ja është duke investuar në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të burimeve njerëzore. Punonjësve auditues do t'iu mundësohet vijimi i trajnimeve dhe arritja e normativit të përcaktuar me SNISA-t për arsimin e vazhdueshëm profesional, si një nga faktorët themelor për kryerjen e auditimeve me kompetencë, cilësi dhe sipas kërkesave të SNISA-ve.

Bazuar në kërkesat për auditime dhe rritjes së portofolit të auditimeve nuk janë të mjaftueshëm numri i auditorëve për ti mbuluar gjithë këto auditime marrë parasysh shtimin e numrit të auditimeve të pajtueshmërisë.

Në mungesë të burimeve të mjaftueshme dhe me qëllim të orientimit të burimeve në fushat me rrezik, ZKA-ja është e detyruar për çdo vit të kontrakttoj kompani private të auditimit për të përkrahur auditimin e një numri të caktuar të organizatave buxhetore të detyruar me ligj për auditime financiare..

6. ZBATIMI I PLANIT VJETOR

Plani vjetor i auditimit do të zbatohet nga 1 shtatori 2024 deri më 31 gusht 2025.

Për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara, ZKA-ja përgatit plane operative audituese, sipas fushave, organizatave buxhetore dhe projekteve të caktuara, shumave të buxhetit, si dhe përbërjen e stafit për realizimin e planit në këtë sezonë audituese, duke u mbështetur nga sistemi informativ i teknologjisë së kryerjes së auditimit-SITA.

Mbi këtë bazë, ZKA përgatit edhe planin kohor për përfundimin e sezonit auditues për secilin projekt auditues i cili inkorporohet në SITA dhe monitorohet në vazhdimësi realizimi i tij.

Prishtinë, Tetor 2024

Vlora Spanca

Auditore e Përgjithshme

Shtojca 1. Plani operativ-subjektet dhe temat

AUDITIMET FINANCIARE DHE TË PAJTUESHMERISË

Tabela 1. Institucione të nivelit qendror/RVA [1 + 49 +3+ 3 = 56]

Entitetet nën auditim		Buxheti 2024
1	Raporti Vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës	3,256,013,730
1	Kuvendi i Kosovës	10,548,018
2	Zyra e Presidentit	4,213,791
3	Zyra e Kryeministrit	22,395,572
4	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës)	906,753,963
	<i>Klauzola e Investimeve</i>	24,272,000
5	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	9,541,135
6	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	89,833,563
7	Auditim i Pajtuëshmërisë	-
8	Ministria e Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë	24,779,272
9	Ministria e Ekonomisë	45,975,878
	<i>Klauzola e Investimeve</i>	12,652,014
10	Ministria e Shëndetësisë	72,545,329
	<i>Klauzola e Investimeve</i>	7,850,000
11	Auditim i Pajtuëshmërisë	-
12	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	174,387,768
13	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore	8,877,671
14	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	88,118,721
15	Auditim i Pajtuëshmërisë	-
16	Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Teknologjisë	100,120,951
17	Universiteti i Prishtinës	31,710,072
18	Ministria për Komunitet dhe Kthim	6,639,660
19	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	244,485,215
	<i>Klauzola e Investimeve</i>	20,960,780
20	Ministria e Punëve të Brendshme	209,912,217
	<i>Klauzola e Investimeve</i>	6,611,250
21	Auditimi i Informatave të Klasifikuara në MPB	-
22	Ministria e Drejtësisë	47,041,887

23	Auditimi i Informatave të Klasifikuara në MD	-
24	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	47,483,313
25	Ministria e Mbrojtjes	153,049,911
26	Auditimi i Informatave të Klasifikuara në MM	-
27	Ministria e Zhvillimit Rajonal	6,889,574
28	Këshilli Prokurorial i Kosovës	17,265,867
29	Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve	1,515,315
30	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	35,806,910
31	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik*	955,713
32	Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës	1,672,045
33	Autoriteti i Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	1,546,894
34	Agjencioni Kundër-Korrupsion*	965,660
35	Zyra Rregullative për Energji*	898,761
36	Organi Shqyrtues i Prokurimit*	502,939
37	Gjykata Kushtetuese e Kosovës	1,992,123
38	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës*	402,209
39	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	269,153
40	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa	239,917
41	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës*	421,794
42	Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit*	475,806
43	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave*	423,714
44	Autoriteti i Aviacionit Civil	687,168
45	Komisioni i Pavarur i Mediave	1,810,286
46	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	9,874,494
47	Institucioni i Avokatit të Popullit	1,300,018
48	Akademia e Drejtësisë	863,245
49	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	2,613,969
50	Agjencioni për Informim dhe Privatësi	474,049
51	Fondet në Mirëbesim	-
52	Agjencioni Kosovar i Privatizimit	4,575,686
53	Agjencioni për Shërbimet e Navigimit Ajror	9,319,409
54	Agjencioni për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar*	321,560
55	Radio Televizioni i Kosovës (PVF)	8,960,000

*Institucionet e Pavarura, auditimi i së cilave do të përkrahët nga kompania private e auditimit.

Komuna [38 + 8 = 46]

Entitetet nën auditim		Buxheti 2024
1	Prishtinë	122,699,998
	<i>Klauzola e Investimeve</i>	<i>1,000,000</i>
2	Auditim i Pajtueshmërisë	-
3	Obiliq	14,248,389
4	Podujevë	31,043,019
	<i>Klauzola e Investimeve</i>	<i>225,450</i>
5	Auditim i Pajtueshmërisë	-
6	Fushë Kosovë	16,285,500
7	Mitrovica e Jugut	28,408,510
8	Graçanicë	8,985,460
9	Mitrovica e Veriut*	6,367,531
10	Zubin Potok*	3,428,092
11	Zveçan*	3,278,670
12	Prizren	65,201,979
	<i>Klauzola e Investimeve</i>	<i>1,000,000</i>
13	Auditim i Pajtueshmërisë	-
14	Mamushë*	2,565,143
15	Malishevë	19,740,806
16	Rahovec	19,804,786
17	Lipjan	23,053,202
18	Shtime	9,906,819
	<i>Klauzola e Investimeve</i>	<i>293,691</i>
19	Suharekë	22,084,868
20	Auditim i Pajtueshmërisë	-
21	Shtërpcë	4,622,800
22	Kllokot*	1,397,829
23	Gjilan	37,189,018
24	Auditim i Pajtueshmërisë	-
25	Viti	16,653,192
26	Novobërdë	3,925,195
27	Ferizaj	26,770,039
28	Auditim i Pajtueshmërisë	-
29	Klinë	14,648,717
30	Pejë	37,457,026
31	Auditim i Pajtueshmërisë	-

32	Istog	14,996,939
	<i>Klauzola e Investimeve</i>	<i>144,804</i>
33	Glllogoc	20,968,992
34	Skenderaj	18,582,311
35	Vushtrri	41,184,014
36	Auditim i Pajtueshmërisë	-
37	Gjakovë	37,483,964
38	Deçan*	13,508,082
39	Dragash*	12,110,967
40	Junik*	2,199,837
41	Kamenicë	14,523,816
42	Leposaviq*	5,832,216
43	Partesh*	1,549,954
44	Ranillug	2,235,239
45	Kaçanik	11,958,982
46	Hani i Elezit*	3,349,278

*Institucionet lokale, auditimi i së cilave do të përkrahët nga kompania private e auditimit.

Ndërmarrje publike [12]

Entitetet nën auditim	
1	Korporata Energjetike e Kosovës, sh.a (KEK)
2	Pasqyrat e veçanta për nevoja të ZRRE-së
3	Pasqyrat e veçanta KPMM
4	KOSTT
5	Pasqyrat e veçanta për nevoja të ZRRE-së
6	Trepça Sh.A
7	KRU "Prishtina" sh.a - Prishtinë
8	Telekomi, sh.a
9	KRM " Uniteti" sh.a - Mitrovicë
10	Ngrohtorja Qendrore "Termokos" - Prishtinë
11	NPH "Ibër - Lepenc" sh.a - Prishtinë
12	Hidrodrini sh.a -Pejë

Projekte që financohen nga huamarrja shtetërore dhe nga donatorët [8]

Entitetet nën auditim	
1	Projekti i Reformës së Sistemit të Asistencës Sociale (BB-MFPT)
2	Ekonomia Dixhitale e Kosovës (BB-MZHE)
3	Projekti i Kosovës për Efiçencën e Energjisë dhe Energjinë e Ripërtëritshme (BB-MZHE-Fondi efiçencë)
4	Forcimi i qeverisjes dixhitale për ofrimin e shërbimeve (BB-MPB/ASHI)
5	Përmirësimi dhe Rehabilitimi i Sistemeve të Ujitjes në Kosovë (BB-MBZHR)
6	Komunat për rininë në Kosovë (BB-MAPL)
7	Projekti për Infrastrukturën e Pasurive të Paluajtshme dhe Gjeohapësinore (BB-AKK)
8	Programi për nxitjen dhe shfrytëzimin e mundësive për sigurinë e ujit (BB-MMPHI/Hidromorava)

B. AUDITIMET E PERFORMANCËS

Tema të auditimeve të performancës [13]

Temat nën auditim	
1	Licencimi i institucioneve parashkollore dhe mbikëqyrja e tyre
2	Efiçienca e Energjisë-BRE KOSST
3	Temë e re
4	Mbrojtja, Zhvillimi dhe ripërtëritja e hapësirave pyjore
5	Siguria dhe të drejtat e konsumatorëve
6	Lejet e ndërtimit Fushë Kosovë
7	DEMOS
8	Furnizimi me barna për shëndetësinë primare dhe sëmundjet e rralla
9	Parkingu nëntokësor në Malishevë
10	Ndërtimi i objektit të Ortopedisë në QKUK
11	Platforma e shërbimeve online e-Kosova
12	Integrimi i sistemeve, krijimi i deponisë së shenimeve dhe implementimi i Intelegjencës së Biznesit
13	Temë e re

Tema të auditimeve të performancës në proces [4]

Temat në proces auditimi	
1	Menaxhimi i sektorit të ndërtimit në Prishtinë
2	Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës-Infrakos
3	ASYCUDA World
4	Auditimi i pajtueshmërisë në KMDK



Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës